



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:161605

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05382971

KPPP.nr.1144/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike-përmbareme të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A., me seli në Prishtinë, rruga “Bill Clinton” pn, kundër debitorit Ximi nga Prishtina, rruga “Fahri Fazliu Nr.341, me NRB: 810456401, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.H. avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbareme P.nr.1036/23 të datës 04.07.2023, të Përmbaremit Privat Valdrin Beka me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 09.02.2023 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Ximi nga Prishtina, me NRB: 810456401, dhe Urdhri Përmbareme P.nr.1036/23 i datës 04.07.2023, i lejuar nga Përmbaremit Privat MBETET NË FUQI.

**A r s y e t i m**

Përmbaremit Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A., me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbareme P.nr.1036/23 të datës 04.07.2023, me të cilin ka lejuar përmbaremin, në bazë të Ekstraktit të verifikuar nga Librat e Kontabilitetit me ID nr.108624 të datës 30.05.2023, duke e obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t’i paguaj kreditorit borxhin

prej 194.22 €, me kamatë prej 4.3 % nga dita e lejimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kontestuar urdhrin përmbartimor në tërësi dhe e ka cilësuar si të pabazuar, me arsyetimin se deri më tani nga krijimi i këtij borxhi kanë kaluar së paku plot 5-6 vite, dhe se ky borxh dhe kërkesa ndaj tij është parashkruar, e kjo në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, konkretisht afati 1 vjeçar i parashkrimit neni 360 par.1. I ka propozuar gjykatës që të aprovet kundërshtimi i debitorit dhe të refuzohet në tërësi ekzekutimi i përcaktuar me urdhrin për përmbartim.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga Librat e Kontabilitetit me ID nr.108624 i datës 30.05.2023, në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.*

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e Përmbaruesit Privat bazohet në dokumentin e besueshëm-Ekstraktin e verifikuar nga Librat e Kontabilitetit me ID nr.108624 të datës 30.05.2023, i cili i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në të janë treguar palët, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret Ekstrakti i lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që i njëjti është dorëzuar në kopje të vërtetuar sipas ligjit.

Gjykata e vlerësoi pretendimin e debitorit se kërkesa e kreditorit është parashkruar, dhe gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar meqenëse në rastin konkret palët ndërgjyqëse janë persona juridik dhe kanë marrëveshje të shërbimeve nga kontratat komerciale të bizneseve, ashtu që ndaj tyre aplikohen dispozitat e nenit 355 të LMD-së ku parashihet se *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”*, e që në rastin konkret për secilën nga kërkesat për periudhën prej 31.03.2021 e deri me datën 30.04.2023, nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se kreditori me datë 04.07.2023, ka ushtruar propozim për përmbarim, përkatësisht brenda afatit tre vjeçar të përcaktuar në dispozitën e lartcekur.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1144/23, datë 09.02.2024

Gjyqtari  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.